UDHËZIM
Nr. 27, datë 16.1.2017

PËR KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE SIPAS QËNDRUESHMËRISË DHE RREZIKSHMËRISË NDAJ ZJARRIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe të pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

UDHËZOJ:

1. Objektet/konstruksionet e ndërtimit sipas shkallës së qëndrueshmërisë ndaj zjarrit dhe rrezikshmërisë ndaj tij ndahen në kategori (klasa), të cilat bazohen në mënyrën e përhapjes së zjarreve në to, sipas klasifikimit të rezistencës së materialeve, që ato kanë në përbërje.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohet si një material ndërtimi çdo produkt i prodhuar, me qëllim që të përfshihet në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit në objekt/konstruksion, produkte që klasifikohen në bazë të reagimit të tyre ndaj zjarrit, të përcaktuara në specifikimet teknike përkatëse, nëse ka, në përputhje me standardet e zbatueshme.

3. Për efekt të kategorizimit sipas qëndrueshmërisë ndaj zjarrit, sipas këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "material", konsiderohet një substancë e vetme bazë ose përzierje të substancave të shpërndara në mënyrë uniforme, si metali, guri, druri, betoni, lesh mineral me lidhësit uniforme shpërndarës, apo polimere etj.;

b) "produkt homogjen", konsiderohet një produkt i përbërë nga një material i vetëm, që ka një dendësi uniforme në të gjithë përbërjen;

c) "produkt johomogjen", konsiderohet një produkt që përbëhet nga një ose më shumë përbërës, në sasi të konsiderueshme dhe/ose jothelbësore;

d) "komponent thelbësor", konsiderohet një material që përbën një element të rëndësishëm në përbërjen e një produkti johomogjen, me një sipërfaqe masë për njësi më të madhe se 1.0 kg/m^2, me një trashësi jo më të vogël se 1.0 mm dhe që është konsideruar të jetë një komponent thelbësor;

e) "komponent jothelbësor", konsiderohet një material që nuk përbën një pjesë të rëndësishme të një produkti johomogjen, me një sipërfaqe masë për njësi më të vogël se 10 kg/m^2, me një trashësi jo më të madhe se 1,0 mm dhe që është konsideruar si një komponent jothelbësor;

f) dy ose më shumë materiale jo të ngjitura "veshje", pa komponent thelbësor janë një komponent jo i konsiderueshëm, dhe për këtë arsye, duhet të përputhet plotësisht me kërkesat për të qenë një komponent jothelbësor;

g) komponentët jothelbësorë, ndahen në komponentë të brendshëm jothelbësorë dhe komponentë të jashtëm, si më poshtë:

- "komponent i brendshëm jothelbësor", është një komponent jothelbësor i veshur nga të dyja anët me të paktën një komponent thelbësor;
- "komponent i jashtëm jothelbësor", është një komponent jothelbësor që në njërën anë nuk është i veshur me një përbërës thelbësor.

4. Kategorizimi sipas qëndrueshmërisë ndaj zjarrit përcaktohet:

a) nga materialet e përdorura në ndërtimin e objektit/konstruksionit të ndërtimit;

b) nga natyra e përdorimit të ndërtesës/ strukturës/konstruksionit;

c) madhësia e ndërtesës/strukturës/ konstruk-sionit;

d) propabiliteti i rënies së zjarrit;

e) nga ngarkesa antizjarr, si dhe vetitë e zjarrit te materialet e ndërtimit.

5. Reagimi i materialeve ndaj zjarrit, sipas shkallës së qëndrueshmërisë, për efekt të këtij kategorizimi,

varet nga parametrat e mëposhtëm:

a) ndezshmëria, që nënkupton aftësinë e një materiali për t'u ndezur;

b) shpejtësia e përhapjes së flakës, që nënkupton shpejtësinë me të cilin flaka përhapet në një material;

c) aftësitë shkrirëse, që ka materiali gjatë ekspozimit në një burim ngrohje;

d) prania e zonave inkandeshente, pasi flaka që shuhet, mund të shkaktojë zjarr përsëri;

e) sasia e nxehtësisë që emetohet në njësinë kohore nga një material në gjendjen e djegies;

f) aftësia e materialit të lëshojë grupe të dukshme të grimcave të ngurta dhe/ose të lëngshme pezull në ajër, si rezultat i djegies jo të plotë në kushte të caktuara;

g) prodhimi i substancave të dëmshme, që përkufizohet si aftësia e një materiali të lëshoj gaze dhe/ose avuj në kushte të përcaktuara me djegie.

6. Kategorizimi kryesor në klasa, sipas shkallës së qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë së materia-leve ndaj zjarrit është:

a) klasa 0, përfshin materiale të padjegshme;

b) klasa 1, përfshin materiale jo të ndezshme të djegshme;

c) klasa 2, përfshin materiale të djegshme rezistente ndaj zjarrit;

d) klasa 3, përfshin materiale djegëse të djegshme;

e) klasa 4, përfshin materiale lehtësisht të ndezshme të djegshme;

f) klasa 5, përfshin materiale shumë të ndezshme të djegshme.

7. Parametrat kryesorë për vlerësimin e rezistencës së zjarrit në materialet e konstruk-sioneve/objekteve ndërtimore, janë:

a) kapaciteti për të ruajtur forcën mekanike nën veprimin e zjarrit, që identifikohet me simbolin "R", si dhe ndjekur nga një numër "n" identifikon elementët konstruktiv dhe mban për një kohë të caktuar "n" forcën mekanike të konstruksionit/ objektit;

b) hermeticiteti, aftësia për të mos lejuar kalimin e flakëve, avujve ose gazeve të nxehtë në anën e paekspozuar të konstruksionit/objektit, që identifikohet me simbolin "E";

c) izolimi termik, aftësia për të reduktuar transmetimin e nxehtësisë, që identifikohet me simbolin "I";

d) "REI" – që identifikon stabilitetin, qëndrueshmërinë, izolimin termik, shprehur në minuta, që një element të ruajë karakteristikat ndërtimore nën ndikimin e zjarrit.

8. Sipas rezistencës së materialive nga efekti i zjarrit të strukturës/konstruksionit/objektit, klasat përcaktohen në: 10, 15, 20, 30, 45, 60, 90, 120, 180, 240 dhe 360, të cilat shprehin kohën në minuta, gjatë së cilës rezistenca ndaj zjarrit e këtyre materialeve duhet të jetë e garantuar.

9. Shërbimi qendror i MZSH-së dhe ai vendor miraton dokumentacionin teknik të mbrojtjes nga zjarri (projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin), të objektit/konstruksionit të ndërtimit, vetëm në përputhje me parametrat kryesorë të vlerësimit të rezistencës të materialeve nga zjarri, si dhe me kategorizimin sipas shkallës së qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë të tij.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, drejtoritë/sektorët e MZSH-së në bashki për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri